




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2574/12</u>	Data Datum <u>25-07-2012</u>	
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Date Date <u>25-07-2012</u>		
PRISHTINE			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **16.07.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4774/11, për z. **Ragip Gjoshi** – Këshilltar politik i Ministrit, në MASHT, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4774-11, për Zyrtarin e lartë, z. Ragip Gjoshi – Këshilltar politik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtushmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. Ragip Gjoshi, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas këtij takimi, zyrtari i lartë, z.Gjoshi, me datën 02.07.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, bashkë me një shkresë përcjellëse, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja me informacionet mbi biznesin "BB Techno" N.t.sh., në të cilat shihet se funksioni i personit të autorizuar të biznesit është bartur te personi i besuar (Neni 14, pika 1 e Ligjit Nr.04/L-051).

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Pretimi

